

RAPORT ARKITEKTONIK



RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS 9 VJEÇARE

“NDRE MJEDA”

SHKODËR

TABELA E PËRMBAJTES

1.	Hyrje	4
1.1	Objekti.....	4
1.2	Përshkrimi	4
1.3	Baza ligjore në projektimin e objektit	4
1.4	Të dhënat e projektimit	5
1.4.1	Parametrat e zhvillimit të zonës së projektit	5
1.4.2	Informacioni kadastral.....	5
1.4.3	Distancat minimale dhe sipërfaqet maksimale të lejuara për zhvillim.....	5
1.4.4	Të dhënat lidhur me nxënësit dhe stafin	5
1.4.5	Norma minimale e truallit për ndërtimin e shkollës	6
1.4.6	Hapësirat e shkollave.....	6
2.	Gjendja ekzistuese e objektit.....	7
2.1	Gjendja e arkitekturës ekzistuese të objektit	7
2.1.1	Gjendja e objektit nga brenda	7
2.1.2	Gjendja e fasadës së objektit	8
2.1.3	Gjendja e sheshit dhe rrethimit.....	9
2.2	Gjendja e strukturës ekzistuese të objektit	9
2.3	Gjendja e rrjetit hidraulik dhe hidrosanitar ekzistues të objektit.....	9
2.4	Gjendja e rrjetit ekzistues të mbrojtjes ndaj zjarrit.....	10
2.5	Gjendja e rrjetit ekzistues elektrik, të ndriçimit dhe monitorimit	10
2.6	Gjendja e rrjetit ekzistues mekanik (ngrohje, ventilim, kondicionim).....	10
3.	Kriteret e Projektimit të Shkollave.....	11
3.1	Projektimi i ambienteve të brendshme shkollore	11
3.1.1	Dhomat e përgjithshme të mësimit (klasat).....	11
3.1.2	Laboraret	12
3.1.3	Dhomat e muzikës dhe vizatimit.....	12
3.1.4	Bibliotekat	13
3.1.5	Salla e edukimit fizik.....	13
3.1.6	Hapësirat për shumë qëllime	13
3.1.7	Hapësira administrative (drejtori/nëndrejtori)	13
3.1.8	Salla e mësuesëve	13
3.1.9	Personeli ndihmës.....	13
3.1.10	Hapësirat ndihmëse.....	13

3.1.11	Dhoma e mjekut / infermierit.....	14
3.1.12	Dhoma e psikologut / punonjësit social.....	14
3.1.13	Mjediset komunikuese	14
3.1.14	Korridoret	14
3.1.15	Shkallët.....	14
3.1.16	Holli.....	15
3.1.17	Depot	15
3.2	Projektimi i ambienteve të jashtme shkollore	15
4.	Ndërhyrjet e propozuara	16
4.1	Rikonstrukcioni i objektit ekzistues.....	16
4.2	Shtesat e reja të objektit	16
4.2.1	Ndërhyrjet e jashtme.....	16
4.2.2	Shtesa e re e shkollës	17
4.2.3	Salla e re sportive.....	17
4.3	Ambjentet e reja të mundësuar.....	17
4.4	Treguesit e llogaritur të shfrytëzimit.....	17

LISTA E FIGURAVE:

Figura 1-1	Planvendosja e shkollës “Ndre Mjeda”	4
Figura 2-1	Foto të gjendjes ekzistuese të objektit nga brenda.....	7
Figura 2-2	Foto të gjendjes ekzistuese të objektit nga jashtë.....	8
Figura 2-3	Foto të gjendjes ekzistuese të shesheve dhe rrethimit.....	9
Figura 2-4	Foto të gjendjes ekzistuese të rrjeteve hidraulike	10

LISTA E TABELAVE:

Tabelë: 1-1	Kategoritë e shkollave nëntëvjeçare në bazë të numrit të nxënësve.....	5
-------------	------------------------------------------------------------------------	---

1. Hyrje

1.1 Objekti

Në këtë raport arkitektonik do të trajtohen ndërhyrjet e propozuara arkitektonike në objektin “Shkolla 9-Vjeçare Ndre Mjeda” (strukturë edukimi me 3 kate). Janë trajtuar në këtë raport gjendja ekzistuese e objektit, shtesat e reja dhe përputhja e institucionit shkollor me legjislacionin në fuqi.



Figura 1-1 Planvendosja e shkollës “Ndre Mjeda”

1.2 Përshkrimi

Shkolla “Ndre Mjeda” është propozuar të rikonstruktohet dhe ndodhet në rrugën Kongresi i Lushjes, Bashkia Shkodër. Ka akses me Bulevardin Zogu I dhe është vendosur në mes të zonës së banuar. Objekti është i pozicionuar në koordinatat gjerësi gjeografike 42°03' 46” dhe gjatësi gjeografike 19°30' 20”.

1.3 Baza ligjore në projektimin e objektit

Objekti është projektuar nga ana arkitektonike dhe urbanistike në përputhje të plotë me legjislacionet në fuqi:

- VKM Nr. 319, datë 12.4.2017 “Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave”
- VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregulores së zhvillimit të territorit”
- VKM Nr. 457, datë 29.6.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregulores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar
- VKM Nr. 671, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregulores së planifikimit të territorit”

1.4 Të dhënat e projektimit

Projektimi arkitektonik, si edhe është përmendur më lart, është bazuar mbi legjilacionin në fuqi, përkatësisht kriterëve të përgjithshme e të veçanta të parashtruara në Rregulloren e zhvillimit të territorit dhe atyre të standardeve të projektimit të shkollave.

1.4.1 Parametrat e zhvillimit të zonës së projektit

Zona e projektit, si edhe është përmendur më lart është Shkolla "Ndre Mjeda" që ndodhet në rrugën Kongresi i Lushjes, Bashkia Shkodër. Njësia strukturore në të cilën ndodhet objekti është SH023.UB, ndërkohë që objekti përfshihet në Kategorinë 3 (Institucion) me parametra:

- Sistemi: Urban
- Lartësi në kate: 5
- Lartësi në metra: 17.4
- Intensitet: 1 (Për objektet e Kategorisë 3)
- Koeficient Shfrytëzimi Territori (KSHT): 50% (Për objektet e Kategorisë 3)
- Koeficient Shfrytëzimi për Rrugët (KSHR): 13%
- Koeficient Shfrytëzimi për hapësirat Publike (KSHP): 5%

1.4.2 Informacioni kadastral

Bazuar në Çertifikatën për Vërtetimin e Pronësisë të truallit dhe të objektit të lëshuar nga Z.V.R.P.P Shkodër jepet informacioni i mëposhtëm:

- Zona Kadastrale: 8591
- Numër Pasurie: 1/229 , Volumi 10 , Faqe 169
- Adresa e Pasurisë: Shkodër
- Lloji i Pasurisë: Truall
- Sipërfaqe Total: 3500m²
- Nga i cili ndërtesë: 651m²
- Pronar: Bashkia Shkodër

1.4.3 Distancat minimale dhe sipërfaqet maksimale të lejuara për zhvillim

Bazuar në VKM Nr. 408, duke qenë se objekti në fjalë është Institucion në pronësi të Pushtetit Vendor dhe po zhvillohet po nga Pushteti Vendor (Bashkia Shkodër) atëherë mbi të aplikohet distanca minimale e lejuar me kufitarët prej $D=Nr. Katesh + 1$ metër dhe kundrejt rrugëve prej $D=2.5$ metra (duke qenë se karrexhatat janë nën 7 metër gjerësi).

Bazuar në VKM Nr. 408, KSHT është 50%, e cila për sipërfaqen totale prej 3500m² përkthehet në 1750 m² të lejuara për njollë ndërtimi. Gjithashtu, duke qenë se Intensiteti është 1, sipërfaqja maksimale e ndërtimit është 3500m².

1.4.4 Të dhënat lidhur me nxënësit dhe stafin

Bazuar në VKM Nr. 319, për shkollat fillore dhe nëntëvjeçare, shkollat ndahen në 4 kategori sipas numrit të nxënësve:

I	II	III	IV
931-1240	621-930	311-620	<310

Tabelë: 1-1 Kategoritë e shkollave nëntëvjeçare në bazë të numrit të nxënësve

Nga më sipër përcaktohet se shkolla është e kategorisë I dhe do të projektohet si e tillë. Numri i studentëve maksimalë është përcaktuar të jetë 900 + 60 parashkollorë. Duke qenë se legjislacioni parashikon një student për gjashtë banorë (në rastin e shkollave nëntëvjeçare), atëherë pritet që shkolla të shërbejë një totali prej 5400 banorësh, këto të fundit në një rreze prej 500 metra nga shkolla, përkatësisht në lagjet Parrucë dhe Xhabiaj.

Bazuar në të dhënat e shkollës, aktualisht janë të punë 57 mësues. Duke shtuar stafin ndihmës, stafi i plotë i shkollës është përlogaritur maksimumi 65 persona.

1.4.5 Norma minimale e truallit për ndërtimin e shkollës

Bazuar në VKM Nr. 671, për shkollat nëntëvjeçare, duhet së paku të plotësohen:

- 1) Rreze shërbimi e shkollës 500-600 metra
- 2) Parcela të ofrojë minimumi $5m^2/nxënës$
- 3) Parcela të jetë mes 1500 dhe 7000 m^2

Nga kushtet e mësipërme, i pari dhe i treti plotësohen ndërkohë që i dyti nuk plotësohet. Duke qenë se objekti në fjalë do të rikonstruktohet, kjo nuk do të merret parasysht.

1.4.6 Hapësirat e shkollave

Hapësirat e shkollave sipas VKM Nr. 319, të cilat duhen mundësuar në çdo shkollë, grupohen në:

Hapësirat e brendshme

- 1) Hapësira akademike
- 2) Hapësira shoqërore
- 3) Hapësira administrative
- 4) Hapësirat ndihmëse
- 5) Mjediset komunikuese

Hapësirat e jashtme

- 1) Hapësira sportive
- 2) Hapësira e oborrit
- 3) Hapësira qarkullimi
- 4) Hapësira e gjelbër

Si edhe përmendet në kapitujt në vazhdim, të gjithë hapësirat e mësipërme janë mundësuar dhe janë në përputhje të plotë me VKM Nr. 319.

2. Gjendja ekzistuese e objektit

2.1 Gjendja e arkitekturës ekzistuese të objektit

2.1.1 Gjendja e objektit nga brenda

Objekti ekzistues është një strukturë me tre kate, pa kat nëndhe. Forma gjeometrike në plan e objektit është e përbërë nga dy pjesë drejtkëndore të shfazuara. Lartësia e katit është 330cm, ndërkohë që lartësia nga dyshemeja në tavan varjon nga 300-310cm. Mbingrijtja e platformës së objektit kundrejt sheshit është jo më shumë se 20cm, lidhur me një shkallë dhe një rampë për personat me aftësi të kufizuar.

Gjatë investigimit në terren, objekti është vënë re se faqet e mureve por më së shumti të tavaneve kanë plasaritje të suvasë. Në katin e dytë kjo është më e dukshme, pasi vihen re edhe shenja të depërtimit të lagështirës nga tarraca – hidroizolimi i tarracës nuk është më efektiv. Sa i përket lyrjes, bojatisja e shkollës duket të jetë e re (si nga jashtë dhe brenda) por duke përdorur ngjyra të ndryshme të cilat nuk bëjnë kontrast.

Shkalla e aksesit është e mbrojtur nga hapja anësore me kangjella metalike ndërkohë që vetë shkalla nuk ka ndriçim direkt në çdo sheshpushim (si edhe urdhërohet nga legjislacioni në fuqi) por ndriçimi vjen nga dritarja e hollit. Mermeret e shkallëve janë shumë të vjetra dhe nuk janë ndërruar që nga krijimi i shkollës. Gjithashtu edhe pllakat janë të vjetra e me përmasa 30x30cm. Janë gjithsej 20 shkelje shkallësh me lartësi 16.5cm, me një sheshpushim në mes.

Dyert e brendshme janë prej druri për klasat, të blinduara për drejtorinë, nëndrejtorinë dhe dhomën e kamerave si dhe duralumini për banjot. Përmasat e dyerve janë 90x200cm me kasë me trashësi 45cm.

Hapësira për ndërrimin e nxënësve në orën e edukimit fizik dhe për magazinim e pajisjeve të edukimit fizik është e pamjaftueshme. Kabina e rojes është përshtatur nën rampën e shkollës dhe jo në një vend të dedikuar. Ambjentet për sanitaret janë të pamjaftueshme dhe jo adekuate.



Figura 2-1 Foto të gjendjes ekzistuese të objektit nga brenda

2.1.2 Gjendja e fasadës së objektit

Gjendja e objektit nga fasada është jo më e mirë se ajo brenda. Vihen re më shumë dëmtime të suvasë dhe bojës, njolla të zeza nga myku dhe lagështira. Xokoli është i zhveshur dhe mykur thuajse plotësisht. E njëjta vlen edhe për parapetin e tarracës, i cili shërben për grumbullimin e ujërave të tarracës.

Dritaret janë me të njëjtat përmasa në të gjithë godinën, me përjashtim të fundit të koridorit dhe asaj të hollit (vetratë). Të gjitha dritaret janë prej duralumini me tek xham dhe me ngjyrë të bardhë. Përmasat (BxH) janë 130x170cm. Pjesa më e madhe e dritareve të katit të parë dhe një pjesë e atyre të katit të dytë janë të pajisura me kangjella. Thuajse gjysma e dritareve janë të pajisura me elementë hijëzimi (perde). Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e mermerëve të dritareve është thyer dhe nxirë nga myku.



Figura 2-2 Foto të gjendjes ekzistuese të objektit nga jashtë

2.1.3 Gjendja e sheshit dhe rrethimit

Në sheshin në hyrje të objektit vihen re disa problematika. E para lidhet me hyrjen në dy objekte private, e cila realizohet me derë nëpërmjet oborrit të shkollës, gjë e cila është e ndaluar. I njëjti objekt pengon gjithashtu lidhjen e plotë të perimetrit të shkollës.

E dyta lidhet me murin rrethues, i cili jo vetëm ka spostime në trajtë dhëmbëzimi për efekt arkitektonik, por edhe një mospërputhje me kufirin e pronës, më së shumti në zonës veriore në kufi me rrugën. Mbi muret përpara objektit ka kangjella ndërsa pas ka rretë me tela.

E treta problematikë është sistemimi i sheshit, si nga para dhe nga pas objektit. Ky shesh është pjesërisht i betonuar dhe pjesërisht me zhavorr përpara objektit, me pjesën prej zhavorri 10cm poshtë asaj prej betoni. Anash sipërfaqes prej zhavorri ndodhet një shirit në formë L-je i cili është i mbjellë me pemë të larta. Sheshi mbrapa ka vetëm një platformë betoni, si fushë për edukimin fizik (futboll+basketboll, me tabela dhe porta të ndryshkura) dhe e gjithë pjesa tjetër është sipërfaqe zhavorri dhe dheu, ku vihet re se ka mbirë bari dhe shkurret në mënyrë të pakontrolluar. Anash platformës është përshtatur me dy shtylla edhe një rretë volejboli. Parapetët prej betoni të cilët shërbejnë si sheshkalime në perimetër të gjurmës së objektit janë gjithashtu pjesërisht të dëmtuar dhe jo në të njëjtin nivel.

Problematika e fundit lidhet me nevojën për restaurim të bustit të Ndre Mjedës në sheshin kryesor. Është vënë re se statuja prej bronzi ka shenja të konsiderueshme ndryshkije, e dukshme nga rrjedhja e oksidit të bakrit (ngjyrë jeshile e çelët).



Figura 2-3 Foto të gjendjes ekzistuese të shesheve dhe rrethimit

2.2 Gjendja e strukturës ekzistuese të objektit

Struktura e objektit ekzistues është 40 vjeçare, e realizuar me muraturë mbajtëse në perimetër dhe dy rreshta me muraturë mbajtëse në koridorin qendror. Në pjesën e shkallëve lidhja me muret bëhet me tra ndërkohë që në të majtë të hapit të parë të shkallës ndodhet një kolonë. Muratura mbajtëse dhe planimetria e mureve janë të njëjta në të tri katet e objektit, me mure mbajtëse me trashësi $t=38\text{cm}$. Soletat e objektit janë me sape, me trashësi $t=20\text{cm}$.

2.3 Gjendja e rrjetit hidraulik dhe hidrosanitar ekzistues të objektit

Aktualisht, furnizimi me ujë i objektit realizohet me anën e një linje që vjen nga ana veriore e objektit dhe lidhet drejt e në ujëmatës e më pas në banjot ekzistuese. Depozitat rezervë të ujit aktualisht mungojnë.

Banjot ekzistuese kanë 6 klozeta dhe 2 lavamanë për kat të dedikuara për nxënësit, të cilat janë të pamjaftueshme. Klozetat janë të tipit allaturk dhe daljet hidraulike të tyre depërtojnë tavanin dhe trasohen në tavanet e katit të mëposhtëm. Nuk vihen re ulje të tavaneve për efekt të vendosjes së klozeta allaturke. Secila nga banjot ka linjën përkatëse dalëse dhe pusetën përkatëse jashtë objektit, të mbuluar me kapak betoni.

Kullimi i ujërave të tarracës bëhet vetëm në një drejtim (drejt fasadës së pasme të objektit). Tarraca ka një pjerrësi prej mesatarisht 1.5-2% në drejtim të një parapeti 50cm të gjerë, tek i cili grumbullohen ujërat e shirave në 5 kolektorë plastikë të cilët shkarkojnë në 5 kolona me tuba plastikë.

Drenazhimi i ujërave sipërfaqësore nuk realizohet me puseta në sheshin në hyrje, por vetëm me ulluqe të përshtatur betoni në drejtim të zonës me zhavorr. Në sheshin mbrapa objektit, drenazhimi realizohet me anën e pusetave me grila, të cilat janë vendosur rreth platformës prej betoni (5 copë).



Figura 2-4 Foto të gjendjes ekzistuese të rrjeteve hidraulike

2.4 Gjendja e rrjetit ekzistues të mbrojtjes ndaj zjarrit

Një sistem fiks i mbrojtjes ndaj zjarrit me anën e hidrantëve mungon në objekt, e cila për bën një rrezik mjaft të madh, duke marrë parasysh që objekti frekuentohet rregullisht nga rreth 800 nxënës. Gjithashtu një sistem alarmi apo detektimi të zjarrit mungon.

2.5 Gjendja e rrjetit ekzistues elektrik, të ndriçimit dhe monitorimit

Linja kryesore elektrike vjen në godinë dhe lidhet në dhomën elektrike e cila ndodhet ngjitur me hyrjen e hollit kryesor. Pozicionimi i kësaj dhome nuk është aspak optimal. Gjithashtu, ndriçimi dhe monitorimi me kamera si dhe e gjithë infrastruktura lidhëse janë të vjetëruara.

2.6 Gjendja e rrjetit ekzistues mekanik (ngrohje, ventilim, kondicionim)

Aktualisht mungon një sistem qoftë qendror, qoftë i decentralizuar për ngrohjen apo kondicionimin e ajrit të objektit. Ventilimi i objektit kryhet natyrisht, vetëm me hapjen e dyerve apo dritareve.

3. Kriteret e Projektimit të Shkollave

Në këtë raport janë trajtuar të gjithë ndërhyrjet arkitektonike në shkollë, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi (VKM Nr. 319). Sa i përket ndërhyrjeve strukturore, hidraulike, mekanike, elektrike dhe mbrojtjes ndaj zjarrit, referohuni në raportet përkatës.

Kriteret e projektimit të shkollave sa i përket aspektit arkitektonik, trajtuar në këtë raport, janë bazuar në Tabelën Nr.3 të VKM Nr. 319 për Shkollat e Arsimit 9-Vjeçar dhe kontrolluar për specifikat e veçanta lidhur po me përmbajtjen e mësipërme, në Kapitullin 4 të këtij legjislacioni (Standardet e Projektimit Arkitektonik). Gjithashtu, për projektimin e të gjithë pajisjeve dhe orendive shkollore dhe ndihmëse është ndjekur Kapitulli 5 i të njëjtit legjislacion. Projektimi i një shkolle merr në bazë mundësimin e të gjithë faciliteteve të përmendura më poshtë, të cilat shpalosen në kapitujt në vijim:

- Dhoma të përgjithshme mësimi
- Laboratore (kimi, fizikë, biologji, informatikë)
- Bibliotekë
- Sallë edukimi fizik (përfshi sallën, dhomat e ndërrimit për meshkuj dhe femra, dhomat e mësuesëve të edukimit fizik, WC dhe depo e pajisjeve të edukimit fizik)
- Drejtoria
- Nëndrejtoria
- Salla e mësuesve
- Salla e aktiviteteve / hapësira për shumë qëllime
- Dhoma e psikologut / punonjësit social
- Dhoma e mjekut / infermierit
- Banjot (WC) për nxënësit dhe stafin
- Hollet dhe korridoret
- Ambjenti i rojes dhe i ruajtjes së të dhënave të kamerave (CCTV)
- Ambjentet teknike (hidraulike, elektrike, mekanike)

Shënim: Vetëm shkollat e mesme kanë nevojë për sekretari, prandaj nuk është përfshirë më sipër

3.1 Projektimi i ambjenteve të brendshme shkollore

3.1.1 Dhomat e përgjithshme të mësimit (klasat)

Si edhe është përmendur në kapitujt e mëparshëm, shkolla është propozuar të përfshihet në Kategorinë I, e cila karakterizohet nga një numër minimal prej 27 klasash (3 paralele për 9 vitet e studimit), ndërkohë që formimi i klasave është minimumi 18 nxënës, me një numër standard prej 30 dhe maksimal prej 36. Projektimi do të realizohet duke marrë parasysh vlerën standarde prej 30 nxënësish në klasë.

Nëse kërkesa është e madhe dhe nevojitet hapja e klasave të reja, atëherë sipas legjilacionit por edhe duke u bazuar në vlerën e mësipërme prej 30 nxënësish në klasë, nuk duhet tejkaluar numri prej 930 nxënësish (ose ekuivalenti i 31 klasave).

Bazuar në Tabelën Nr.3, sipërfaqja e nevojshme bruto për formimin e një klase në shkolla të Kategorisë I është $1.5m^2/nxënës$ ($45m^2$) ndërkohë që sipërfaqja e brendshme neto (sipas Kapitullit 4) duhet përmbajtur mes $1.2-1.4m^2/nxënës$ ($36-42m^2$). Parametrat e mësipërm janë përmasues / detyrues për shtesat dhe kontrollues për ambjentet ekzistuese.

Përmasimi i klasave, i cili i përmbahet sipërfaqeve të mësipërme dimensionohet në një raport brinjësh drejtkëndore afërsisht 2:3, me distancë maksimale nga banka e fundit tek dërrasa prej jo më shumë se 7 metra dhe nga cepi anësor i dërrasës deri tek dritarja prej jo më shumë se 6 metra – për qëllim shikueshmërie. Distanca nga pozicionimi i bankës së parë deri tek dërrasa duhet të tejkalojë 2 metrat.

Të gjithë këndet e shikimit kontrollohen për të mos kaluar 30 gradët. Drita natyrale zgjidhet gjithmonë të vijë nga ana e majtë e nxënësve dhe kjo lidhet drejtpërdrejt me orientimin e klasave.

Sa i përket vendosjes dhe përmasimit të tavolinave të nxënësve, ato janë faktor i grupmohës, me diferenca të vogla mes tyre. Organizimi i përgjithshëm është me 3 rreshta me nga 5 rradhë bankash dopio. Janë përzgjedhur:

- Gjerësi tavoline: 120 cm (60 cm / nxënës)
- Thellësi tavoline: 60 cm
- Lartësi tavoline: 70 cm
- Distancë mes tavolinave anësore: minimumi 55 cm
- Distancë mes tavolinave të njëpasnjëshme: minimumi 60 cm
- Distancë mes tavolinave dhe mureve apo radiatorëve: 20 cm

Një parametër mjaft i rëndësishëm sa i përket projektimit të klasave është edhe përmasimi i saktë i dritareve. Është e këshilluar që sipërfaqja e dritareve të jetë mes 1/5 dhe 1/6 (16.6-20%) të sipërfaqes së dyshemesë së klasës. Kurrë nuk duhen përdorur dritare në vlerën 8% për dritaret e orientuara nga jugu, 10% për ato nga lindje-perëndimi dhe 15% për ato nga veriu. Parapeti i dritareve (lartësia nga dyshemeja deri tek pragu pragu i dritares) është i sugjerueshëm të jetë 90 cm. Shtesat projektohen në përputhje me parametrat e mësipërm ndërsa strukturat ekzistuese vetëm kontrollohen. Të gjithë dritaret duhet të plotësojnë kushtet minimale sa i përket termoizolimit – minimumi dopio xham me vlerë $U=1.2 \text{ W/m}^2\text{K}$. Këshillohet përdorimi i dritareve me trup duralumini por veshje plastike.

Referuar normativave dhe standardeve europiane të projektimit, hapja e dyerve duhet të projektohet nga ana e jashtme për efekt sigurie dhe evakuimi në raste emergjence/avarie, si dhe dyert e klasave duhet të pozicionohen në një thellësi nga muret e korridorit, e cila diktohet nga gjerësia e derës e përcaktuar në normativat përkatëse.

Gjithashtu, për klasat duhen mundësuar kushtet minimale sa i përket ndriçimit minimal natyral, i cili duhet të jetë mes 400 dhe 500 lux dhe kushtet e komoditetit akustik të cilat janë 47 dB për muret dhe 35 dB për xhamin e dyerve.

3.1.2 Laboratoret

Për çdo shkollë me të paktën 18 klasa është kusht përfshirja e të paktën një laboratorit për secilën: kimi, fizikë, biologji dhe informatikë (ky i fundit shërben edhe për gjuhët e huaja). Secili laborator, në bazë të legjilacionit, duhet të jetë rreth $2.2 \text{ m}^2/\text{nxënës}$ (~66m² për objektin), përfshi këtu dhe ambientet ndihmëse dhe pajisjet parapërgatitëse.

3.1.3 Dhomat e muzikës dhe vizatimit

Sipas legjilacionit, këto mësimë për shkollat 9-vjeçare mund të zhvillohen në klasat e mësimi, por gjithashtu mund tu vihet në dispozicion salla e aktiviteteve / hapësira për shumë qëllime.

3.1.4 Bibliotekat

Përdorues të bibliotekave janë si nxënësit ashtu edhe mësuesit, të cilat merren parasysh në llogaritje. Kushti minimal për përmasimin e bibliotekave në shkollat 9-vjeçare është garantimi i të paktën 18 m² ose arritja e një vlere optimale prej 0.1 m²/person (~90m² për objektin).

3.1.5 Salla e edukimit fizik

Bazuar në Tabelën Nr. 3, sipërfaqja minimale e cila duhet rezervuar për sallën e edukimit fizik është 405m². Salla duhet të jetë në çdo rast e mbyllur, me lartësi minimale prej 6 metrash dhe përmasa të jashtme 3 metra më të mëdha se ato të fushës së zgjedhur. Përzgjedhja e llojit të fushës lidhet drejtpërdrejt me kurrikulën mësimore, por është e preferueshme të jetë me shumë qëllime (basketboll, volejbol dhe gjimnastikë).

Për shkollat 9-vjeçare duhet që së paku, fusha të jetë me përmasa 12 m x 24 m (minimale për basketbollin) dhe e përshtatur për basketboll, volejbol dhe gjimnastikë. Veç kësaj, në shërbim të sallës duhet të mundësohen minimumi:

- Dy garderoba me minimumi 16m² secila (meshkuj/femra)
- Dy banjo/dushe me minimumi 16m² secila (meshkuj/femra)
- Një depo për materialet mësimore të edukimit fizik me minimumi 16m²
- Një mjedis për mësuesit me banjo dhe garderobë me minimumi 10m²

3.1.6 Hapësirat për shumë qëllime

Në hapësirat për shumë qëllime bëjnë pjesë mjediset, të cilat mund të përdoren për disa qëllime si p.sh salla mbledhjesh nxënës-mësues, sallë takimesh për mësues-prindër, për të zhvilluar simpoziume, për të shfaqur materiale të ndryshme filmike, etj. Për shkollat 9-vjeçare duhet të jetë minimumi 70m², por rekomanduar prej 0.2m²/nxënës (~170m² për objektin).

3.1.7 Hapësira administrative (drejtori/nëndrejtori)

Zyra e drejtorit duhet të jetë minimumi 20m² ndërsa ajo e nëndrejtorit minimumi 12m². Për shkolla të Kategorisë I nevojiten 2 nëndrejtori. Sekretaria nuk është e detyrueshme për 9-vjeçarët.

3.1.8 Salla e mësuesëve

Për shkollat 9-vjeçare, salla e mësuesëve nevojitet të ketë rreth 2.5m² për mësues por kurrë më pak se 30m².

3.1.9 Personeli ndihmës

Për personelin ndihmës duhet të parashikohet gjithmonë një minimum prej 2m²/person. Këtu përfshihen sanitaret dhe roja. Gjithashtu duhet rezervuar një shtesë prej 2m² në çdo kat për qëllim mirëmbajtje.

3.1.10 Hapësirat ndihmëse

Tek hapësirat ndihmëse përfshihen banjot për sanitaret, nxënësit dhe mësuesit. Për secilën kategori që u shërbehet duhet mundësuar të paktën:

- Për nxënës djem: 2 WC dhe 2 lavamane për çdo 100 nxënës
- Për nxënëse vajza: 4 WC dhe 2 lavamane për çdo 100 nxënëse
- Mësuesit: 2 WC dhe 1 lavaman për çdo 20 mësues
- Mësueset: 2 WC dhe 1 lavaman për çdo 20 mësuese

Gjithashtu kërkesa të tjera lidhur me WC-të sipas legjislacionit janë:

- Muret duhet të vishen me pllaka në mënyrë që të mos gërvishten dhe të mos pranojnë shkrim mbi to, deri në lartësi 1.6m
- Dyert e WC-ve duhet të jenë 70cm të gjera
- Kabina e WC-ve nuk duhet të jenë më të vogla se 1.3m x 0.9m me lartësi minimale 2 metra
- Sanitaret duhet të jenë të orientuara nga veriu, të hidroizoluara dhe të mirëventiluara
- Duhet parashikuar një rubinet dhe piletë për larjen e WC-ve

3.1.11 Dhoma e mjekut / infermierit

Duhet të vendoset në katin e parë të ndërtesës me një sipërfaqe të detyruar prej 17-18m² (përmasa të këshilluara 6x3m). I duhet mundësuar një lavaman / kabinet për larje duarsh, dritare me sipërfaqe sa 1/6 e sipërfaqes së kabinetit dhe ndriçim artificial prej 100 lux.

3.1.12 Dhoma e psikologut / punonjësit social

Duhet të vendoset në katin e parë të ndërtesës me një sipërfaqe të detyruar prej 17-18m² (përmasa të këshilluara 6x3m). I duhet mundësuar një lavaman / kabinet për larje duarsh, dritare me sipërfaqe sa 1/6 e sipërfaqes së kabinetit dhe ndriçim artificial prej 100 lux.

3.1.13 Mjediset komunikuese

Të gjitha kategoritë e shkollave kanë nevojë për mjedise komunikuese, hyrje, holl, korridore, shkallët, rampat, parrakë për shkallët. Hyrjet e shkollës duhen projektuar të tilla që të mundësojnë hyrje - dalje të lirshme të nxënësve. Përmasat e dyerve të hyrje - daljeve varen edhe nga numri i nxënësve të shkollës. Për çdo hyrje për në shkollë duhet të projektohet nënstreha.

Në çdo kat duhet të ketë së paku një dalje emergjente, në distanca sa më të mëdha nga shkalla kryesore. Distanca maksimale në mes të çdo dere dhe daljes së emergjencës së katit duhet të jetë 30 m. Gjerësia e daljes emergjente duhet të jetë 0,55 m për çdo 60 persona. Në katin përdhe duhet të ketë të paktën dy hyrje. Gjerësia e hyrjes duhet të jetë 0,5cm për çdo nxënës.

3.1.14 Korridoret

Korridoret duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Gjerësia e korridorit kur ai shërben për klasat vetëm nga njëra anë duhet të jetë minimumi 2 m për 4 klasa. Për më shumë klasa duhet të zgjerohet 0,2 m për çdo klasë.
- Gjerësia e korridorit kur ai shërben për klasa në të dyja anët duhet të jetë minimumi 3 m.
- Lartësia e korridorit duhet të jetë minimumi 3m.

3.1.15 Shkallët

Shkallët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Gjerësia e krahut të shkallëve: minimumi 1,2 m /100 nxënës + 0,2 cm për çdo 100 nxënës të tjerë dhe maksimumi 3,0 m
- Nuk duhet të projektohen dhe të zbatohen shkallë spirale dhe trapezoidale.
- Lartësia e parrakut të shkalleve duhet të jetë 1,10 m
- Për shkallë me gjerësi deri në 1,5 m parraku vendoset vetëm në njërin anë.
- Për shkallë me gjerësi deri në dy 2 m, parraku duhet të vendoset nga të dyja anët.
- Për shkallë më të gjera se 2 m duhet vendosur parrak edhe në mes.
- Në çdo kat duhet të ketë minimumi dy shkallë në distancë nga njëra- tjetra sa më të mëdha që të jetë e mundur

3.1.16 Holli

Madhësia e hollit varet drejtpërdrejt nga numri i nxënësve, ku sipërfaqja e sugjeruar përlllogarit të jetë $0.1\text{m}^2/\text{nxënës}$ (ose rreth 90m^2 për objektin).

3.1.17 Depot

Depot janë mjedise, që shërbejnë për inventar dhe materiale të tjera. Sipërfaqja e depove mund të jetë nga 18m^2 deri 40m^2 .

3.2 Projektimi i ambienteve të jashtme shkollore

Si edhe u përmend më lart, hapësira të jashtme quhen:

- Hapësira sportive
- Hapësira e oborrit
- Hapësira qarkullimi
- Hapësira e gjelbër

Bazuar në VKM Nr. 319, duhet të garantohen së paku për secilën nga të mësipërmet:

- Hapësira sportive – përcakohet nga kurrikula, minimumi 405m^2
- Hapësirë oborri – $1\text{m}^2/\text{nxënës}$
- Hapësirë qarkullimi (rrugë, trotuare, shtigje) – 20% e hapësirës së jashtme (350m^2)
- Hapësirë e gjelbër – 30% e hapësirës së jashtme (525m^2)

4. Ndërhyrjet e propozuara

4.1 Rikonstrukcioni i objektit ekzistues

Objekti ekzistues është propozuar që të rehabilitohet plotësisht. Këtu përfshihen ndërhyrjet e mëposhtme:

- Heqje e plotë e suvasë së brendshme dhe të jashtme të objektit
- Heqje e pllakave të dysHEMEVE, shkallëve dhe banjove
- Heqje e dritareve ekzistuese, përfshi mermerin dhe kangjellat
- Heqje e hidroizolimit ekzistues
- Heqje e dyerve ekzistuese
- Heqje e muraturave jo-mbajtëse dhe mbajtëse (sipas planit arkitektonik)
- Heqje e pajisjeve hidrosanitare
- Çmontim i plotë i rrjetit hidraulik të brendshëm dhe të jashtëm (furnizim me ujë, kanalizime të ujërave të ndotur, atmosferikë)
- Risuvatim nga brenda dhe vendosje e termoizolimit në fasadë
- Rilyerje e objektit (brenda/jashtë)
- Shtrim i ri me pllaka dhe mermer për dysHEME, shkallë, banjo
- Vendosje e dritareve të reja, shoqëruar me parmakë të rinj dhe elementë hijëzimi
- Vendosje e hidroizolimit të ri në tarracë
- Vendosje e dyerve të reja, në përputhje me kushtin, si në Vizatime
- Rindërtimi i banjove dhe rivendosja e pajisjeve të reja hidrosanitare (shiko Raportin Hidraulik)
- Rindërtim i infrastrukturës elektrike dhe ndriçimit artificial (shiko Raportin Elektrik)
- Ndërtim i sistemit të ri të ngrohjes dhe ventilimit (shih Raportin Mekanik)

4.2 Shtesat e reja të objektit

Tek shtesat e reja të objektit përfshihen:

- Godina e re (që lidhet me godinën e vjetër) në verilindje – objekt me 4 kate mbi tokë dhe dhomë teknike nën tokë (elektrike + hidraulike)
- Salla e re sportive (që lidhet me godinën e vjetër) në jugperëndim
- Risistemimi i oborrit, shtigjeve dhe hapësirave të gjelbra

4.2.1 Ndërhyrjet e jashtme

Në Kapitullin 3 të këtij Raporti, u përmendën të gjithë kushtet për projektimin e objektit të ri dhe kontrollit të objektit të vjetër. Sa i përket ambjenteve të jashtme janë respektuar sipërfaqet e kërkuara:

- Hapësira sportive – përcakohet nga kurrikula, minimumi 405m²
- Hapësirë oborri – 1m²/nxënës
- Hapësirë qarkullimi (rrugë, trotuare, shtigje) – 20% e hapësirës së jashtme (350m²)
- Hapësirë e gjelbër – 30% e hapësirës së jashtme (525m²)

Në risistemim është mundësuar aksesimi në shkollë nga dy porta, e cila gjithashtu i shërben zjarrfikëseve në rast emergjence. Gjithashtu, krahas ndërhyrjeve të mësipërme janë propozuar ndërhyrje në prishjen dhe rivendosjen e murit rrethues të shkollës.

4.2.2 Shtesa e re e shkollës

Shtesa e re e shkollës është propozuar të jetë me 4 kate mbi dhe një kat nën dhe. Kati i nëndheshëm i godinës së re do të shërbejë për vendosjen e të gjithë ambjenteve teknike (hidraulike, elektrike). Ajo përlogaritet të ketë një gjurmë prej 169 m² përfshi këtu shkallën. Lartësia e kateve është e njëjtë me godinën ekzistuese (ndërsa për nënkatin 2.55m). Në përbërje të kësaj strukture janë 4 ambjente të reja për klasa, 2 WC dhe një administrative për kat, një palë shkallë emergjence.

4.2.3 Salla e re sportive

Salla e re sportive ka një sipërfaqe prej 431 m² (më e madhe se 420m²) dhe është në përputhje të plotë me specifikimet e VKM Nr. 319. Ajo do të shërbejë për basketboll, volejbol dhe gjimnastikë, por mund të përshtatet për minifutboll.

4.3 Ambjentet e reja të mundësuar

Objekti i ri dhe ai ekzistues krijojnë së bashku shkollën e re, në të cilën janë mundësuar:

- Dhoma të përgjithshme mësimi – 30 klasa + 2 klasa të lira, për arsye zgjerimi të kapacitetit të shkollës deri në 960 nxënës, secila për 30 nxënës, me sipërfaqe minimale 45m² për klasat e reja (të vjetrat nuk ndryshojnë)
- Laboratore – fizike dhe informatike (dhoma të ndryshme, 24m²), kimie dhe biologjie (dhoma të ndryshme, 41m²)
- Bibliotekë (41m²)
- Sallë edukimi fizik (përfshi sallën me lartësi kati 5.95m dhe sipërfaqe 420m², dhomat e ndërrimit për meshkuj dhe femra me 11m² secila, depo e pajisjeve të edukimit fizik me 8m²)
- Drejtoria (18 m²)
- Nëndrejtoria (18 m²)
- Salla e mësuesve (41m²)
- Salla e aktiviteteve / hapësira për shumë qëllime (100m²)
- Dhoma e psikologut / punonjësit social (12.5m²)
- Dhoma e mjekut / infermierit (12.5m²)
- Banjot (WC) – 30 WC për nxënësit dhe 18 WC për stafin, duke respektuar përmasat dhe numrin e lavamanëve për të gjitha
- Hollet dhe korridorët – në çdo kat sipërfaqja e plotë shkon 920m², nga të cilat 63m² janë holl dhe 148m² korridore
- Ambjenti i rojes dhe i ruajtjes së të dhënave të kamerave (CCTV) – 9m²
- Ambjentet teknike (hidraulike, elektrike, mekanike) – 169 m² të gjitha bashkë, nën dhe

4.4 Treguesit e llogaritur të shfrytëzimit

- Sipërfaqe e parcelës që zhvillohet: 3500m²
- Sipërfaqe e parcelës e zënë nga struktura: 1324m²
- Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit: 3489m²
- Lartësi në kate: 4
- Koeficienti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim: 45% (<50%, i lejuar)
- Intensiteti i lejuar i ndërtimit për kategorinë e zonës: 0.997 (<1, i lejuar)
- Lartësi maksimale strukture nga toka: (13.75 m < 17.4 m e lejuar)
- Numri i kateve nën tokë: 1